



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 464 Akti

V E N D I M

(I NDËRMJETËM)

Nr. 9, datë 17.6.2022

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Roland Ilia	Kryesues
Etleda Çiftja	Relatore
Pamela Qirko	Anëtare

asistuar nga sekretarja gjyqësore, znj. Resilda Bilaj, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Tonci Petkovic, në datën 15.6.2022, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, zhvilloi seancën dëgjimore mbi çështjen që i përket subjektit të rivlerësimit Gjergji Tako, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit është institucioni që kryen procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, bazuar në paragrafin 5, të nenit 179/b, të ligjit nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, në pikën 5, të nenit 3 dhe në pikën 1, të nenit 5, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.
2. Subjekti i rivlerësimit Gjergji Tako, aktualisht, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, i nënshtrohet rivlerësimit, *ex officio*, në bazë të pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.
3. Bazuar në pikën 2, të nenit 14, të ligjit nr. 84/2016 dhe në Rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim Komisioni) ka hedhur shortin në datën 16.12.2019, nga i cili rezultoi se subjekti i rivlerësimit Gjergji Tako do t’i nënshtrohet procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues i përbërë nga komisionerët Roland Ilia, Etleda Çiftja dhe Pamela Qirko. Relator i çështjes u zgjodh me short komisionere Etleda Çiftja.

4. Në mbledhjen e trupit gjykues të datës 23.12.2019, u caktua me mirëkuptim kryesues komisioneri Roland Ilija, u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupit gjykues, si dhe u vendos fillimi i hetimit administrativ, me qëllim kryerjen e procedurave të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit Gjergji Tako.

5. Në referim të pikës 1, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, për subjektin e rivlerësimit Gjergji Tako nisi procesi i rivlerësimit dhe hetimi i thelluar administrativ sipas nenit 45, të ligjit nr. 84/2016 për të vlerësuar të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme për procedurën e rivlerësimit. Në vijim, nga relatori i çështjes janë ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 5, të nenit 14, të ligjit nr. 84/2016.

6. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në Komision janë administruar raportet e hartuara nga institucionet: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK); dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë. Këto raporte janë administruar nga relatori me fillimin e hetimit administrativ.

7. Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me rezultatet e hetimit dhe provat e grumbulluara për të tria kriteret, në datën 6.4.2022, vendosi: (i) përfundimin e hetimit kryesisht për subjektin e rivlerësimit Gjergji Tako, bazuar në relativimin mbi rezultatet e hetimit të paraqitur nga relatori i çështjes; (ii) njoftimin e subjektit të rivlerësimit për t’u njohur me provat e administruara nga Komisioni në përputhje me nenin 47, të ligjit nr. 84/2016 dhe me nenet 45-47 dhe 35-40 të Kodit të Procedurës Administrative; (iii) kalimin e barrës së provës subjektit për të paraqitur prova dhe shpjegime për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, mbështetur në pikën 5, të nenit 4, të Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 52, të ligjit nr. 84/2016.

8. Në datën 6.4.2022, përmes postës elektronike¹, trupi gjykues njoftoi subjektin e rivlerësimit mbi: (i) rezultatet e hetimit kryesisht; (ii) kalimin e barrës së provës sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe të sjellë prova për të provuar të kundërtën; si dhe (iii) njohjen me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47, të ligjit nr. 84/2016 dhe nenet 45 - 47 dhe 35 - 40 të Kodit të Procedurave Administrative. Në këtë njoftim, subjektit iu kërkua të paraqiste edhe shpjegime brenda datës 21.4.2022

9. Në datën 21.4.2022, subjekti i rivlerësimit, përmes postës elektronike², i dërgoi Komisionit parashtrimet lidhur me rezultatet e hetimit, si dhe depozitoi në zyrën e protokollit³, pranë zyrave të Komisionit, parashtrimet dhe provat e reja në mbështetje të barrës së provës.

10. Komisioni, me anë të postës elektronike⁴, njoftoi subjektin e rivlerësimit se trupi gjykues, bazuar në nenin 55, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në Kodin e Procedurave Administrative,

¹E-mail datë 6.4.2022, “Komisioni – Njoftim mbi përfundimin e hetimit administrativ kryesisht mbi procesin tuaj të rivlerësimit”.

²E-mail datë 21.4.2022.

³Parashtrime datë 21.4.2022 (nr. *** prot., datë 21.4.2022, në Komision).

⁴E-mail datë 22.4.2022, “Komisioni – Ftesë për t’u dëgjuar në seancë dëgjimore lidhur me procesin e rivlerësimit”.

vendosi ta ftojë për t'u dëgjuar në seancë dëgjimore lidhur me rezultatet e hetimit për vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale, në datën 27.4.2022, në orën 10:00.

11. Pasi dëgjoi subjektin e rivlerësimit në seancën e datës 27.4.2022, trupi gjykues konstatoi se: (i) Komisioni, në rezultatet e hetimit, është shprehur me rezervë lidhur me dokumentacionin e paraqitur nga subjekti për vërtetimin e të ardhurave të realizuara në Itali nga shtetasit R. B. dhe I. S., pasi nuk ishin paraqitur në formën e duhur ligjore dhe subjekti i rivlerësimit, në parashtrimet shitesë të depozituara në datën 26.6.2022 pranë Komisionit, ka paraqitur deklaratën noteriale nr. ***, datë 26.4.2022, të bashkëshortes së tij, znj. M. T., e cila deklaron se motra e saj D. D. ka shkuar në Itali për të siguruar dokumentacionin e nevojshëm për subjektin Gjergji Tako; (ii) subjekti i rivlerësimit, në datën 28.4.2022, ka dërguar nëpërmjet postës elektronike kopje të vendimit, që ka lidhje me pezullimin e hetimeve lidhur me procedimin nr. ***, viti 2010, ndaj shtetasit A. S., të cilin e ka marrë në format *word* nga arkiva e kompjuterit të tij; (iii) Komisioni, në datën 16.3.2022, ka aplikuar në sistemin elektronik të ASHK-së për t'u njohur me dokumentacionin teknik e ligjor mbi bazën e të cilit është regjistruar pasuria nr. ***, z. k. ***, e llojit "truall", nga të cilat truall me sip. 275 m² dhe 188 m² ndërtesë, në Përmet, në pronësi të personit të lidhur P. T. (si bashkëpronar) dhe përgjigjja e ASHK-së ende nuk ishte administruar.

12. Sa më sipër, Komisioni, me vendimin e datës 28.4.2022, vendosi: (i) të riçelë hetimin administrativ kryesisht ndaj subjektit Gjergji Tako për të tria kriteret e rivlerësimit; (ii) që subjekti i rivlerësimit të paraqesë në formën e kërkuar nga ligji: (a) dokumentacionin ligjor lidhur me të ardhurat e realizuara në Itali nga shtetasit I. S. dhe R. B.; (b) vendimin e pushimit të procedimit penal nr. ***, viti 2010, në ngarkim të shtetasit A. S. bashkë me procesverbalin e marrjes në pyetje të këtij shtetasi; (iii) të administrojë nga Drejtoria Vendore e ASHK-së Përmet dokumentacionin teknik e ligjor mbi bazën e të cilit është bërë regjistrimi i pasurisë nr. ***, z. k. ***, Përmet; (iv) të shtrijë hetimin lidhur me vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit duke përzgjedhur nga lista e statistikave të paraqitura nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë (pjesë e dosjes së raportit të rivlerësimit profesional të KLP-së) dosje penale të ndjekura nga subjekti Gjergji Tako për periudhën 11.12.2007 – 8.10.2016, duke përjashtuar dosjet e analizuara në raportin nr. *** prot., datë 8.7.2020, të KLP-së, "Për vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit Gjergji Tako".

13. Komisioni, me anë të postës elektronike⁵, njoftoi subjektin se me vendimin e datës 28.4.2022 ka vendosur kryesisht të riçelë hetimin administrativ për të tria kriteret e rivlerësimit dhe pas përfundimit të hetimit do të njoftohet në lidhje me hetimin e kryer dhe rezultatet shitesë.

14. Në mbledhjen e datës 4.5.2022, Komisioni përzgjedhi në mënyrë rastësore nga lista e statistikave të paraqitura nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë 16 dosje penale të ndjekura nga subjekti Gjergji Tako për periudhën 11.12.2007 – 8.10.2016, duke përfshirë pesë dosje penale të përfunduara me vendim mosfillim procedimi penal, pesë dosje penale të përfunduara me vendim pushim procedimi penal dhe pesë dosje penale të dërguara për gjykim. Gjithashtu, Komisioni vendosi të kërkojë nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit

⁵E-mail datë 28.4.2022.

Gjyqësor Tiranë listën e çështjeve penale të hetuara nga subjekti Gjergji Tako për periudhën 11.12.2007 – 8.10.2016, për veprat penale të parashikuara nga nenet: 244, 245, 256, 257, 258, 159, 260, 319, 319/a, 319/b, 319/c, 319/d, 283, 283/a, 284, 284/c dhe 285/a të Kodit Penal, me qëllim përzgjedhjen në mënyrë rastësore të çështjeve për shqyrtim.

15. Më pas, në mbledhjen e datës 10.5.2022, Komisioni përzgjodhi në mënyrë rastësore nga lista e përcjellë nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë pesë dosje penale të regjistruara për kryerjen e veprave penale të parashikuara nga nenet: 244, 245, 256, 257, 258, 159, 260, 319, 319/a, 319/b, 319/c, 319/d, 283, 283/a, 284, 284/c dhe 285/a të Kodit Penal.

16. Në datën 2.6.2022, subjekti dorëzoi në protokollin e Komisionit⁶ parashtrime shtesë dhe prova lidhur me sqarimin e çështjes së ndjekur prej tij ndaj shtetasit A. S.

17. Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me rezultatet e hetimit shtesë dhe provat e grumbulluara për të tria kriteret, në datën 3.6.2022, vendosi: (i) përfundimin e hetimit kryesisht shtesë për subjektin e rivlerësimit Gjergji Tako, bazuar në relatimin mbi rezultatet e hetimit shtesë të paraqitur nga relatori i çështjes; (ii) njoftimin e subjektit të rivlerësimit për t'u njohur me provat e administruar nga Komisioni në përputhje me nenin 47, të ligjit nr. 84/2016 dhe me nenet 45-47 dhe 35-40 të Kodit të Procedurës Administrative; (iii) kalimin e barrës së provës subjektit për të paraqitur prova dhe shpjegime, për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit shtesë, mbështetur në pikën 5, të nenit Ç, të Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

18. Në datën 3.6.2022, përmes postës elektronike⁷, trupi gjykues njoftoi subjektin e rivlerësimit mbi: (i) rezultatet e hetimit kryesisht shtesë; (ii) kalimin e barrës së provës sipas nenit 52, të ligjit nr. 84/2016 dhe të sjellë prova për të provuar të kundërtën; si dhe (iii) njohjen me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenet 45 - 47 dhe 35 - 40 të Kodit të Procedurave Administrative. Në këtë njoftim, subjektit iu kërkua të paraqiste edhe shpjegime brenda datës 13.6.2022.

19. Në datën 13.6.2022, subjekti dorëzoi në protokollin e Komisionit⁸ parashtrimet dhe provat lidhur me rezultatet e hetimit shtesë.

20. Komisioni, me anë të postës elektronike⁹, njoftoi subjektin e rivlerësimit se trupi gjykues, bazuar në nenin 55, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në Kodin e Procedurave Administrative, vendosi ta ftojë për t'u dëgjuar në seancë dëgjimore lidhur me rezultatet e hetimit për vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale, në datën 15.6.2022, në orën 10:00.

II. SEANCA DËGJIMORE

21. Në datën 27.4.2022 u zhvillua seanca e parë dëgjimore në prezencë të subjektit të rivlerësimit dhe në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Tonci Petkovic, në përputhje me

⁶Parashtrime shtesë dhe prova (nr. *** prot., datë 2.6.2022, në Komision).

⁷E-mail datë 3.6.2022, “Komisioni – Njoftim mbi përfundimin e hetimit shtesë mbi procesin tuaj të rivlerësimit”.

⁸Protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 13.6.2022.

⁹E-mail datë 13.6.2022, “Komisioni – Ftesë për t'u dëgjuar lidhur me rezultatet e hetimit shtesë”.

kërkesat e nenit 55, të ligjit nr. 84/2016. Subjekti i rivlerësimit u paraqit personalisht në seancë bashkë me avokatin R. K.

22. Relatori i çështjes paraqiti rezultatet e arritura nga Komisioni përgjatë fazës së hetimit administrativ, të kryer mbi të tria kriteret e rivlerësimit dhe të kaluara si barrë prove apo për shpjegime.

23. Z. Gjergji Tako, pasi dëgjoi relacionin, shprehu qëndrimin e tij, duke parashtruar shpjegimet përkatëse lidhur me gjetjet e hetimit kryesisht, si dhe mbi procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij.

24. Në përfundim të seancës dëgjimore të datës 27.4.2022, subjekti i rivlerësimit Gjergji Tako, kërkoi konfirmimin në detyrë.

25. Më pas, në datën 15.6.2022 u zhvillua seanca e dytë dëgjimore lidhur me rezultatet e hetimit administrativ shtesë në prezencë të subjektit të rivlerësimit, avokatit të tij R. K. dhe në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Tonci Petkovic, në përputhje me kërkesat e nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.

26. Relatori i çështjes paraqiti rezultatet e arritura nga Komisioni përgjatë fazës së hetimit administrativ shtesë, të kryer mbi të tria kriteret e rivlerësimit dhe të kaluara si barrë prove apo për shpjegime.

27. Z. Gjergji Tako, pasi dëgjoi relacionin, shprehu qëndrimin e tij, duke parashtruar shpjegimet përkatëse lidhur me gjetjet e hetimit kryesisht shtesë, si dhe mbi procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij. Në përfundim të seancës dëgjimore, subjekti i rivlerësimit Gjergji Tako, kërkoi konfirmimin në detyrë.

28. Seanca dëgjimore e datës 15.6.2022 u ndërpre, për të rifilluar në datën 17.6.2022, për shpalljen e vendimit.

III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

29. Z. Gjergji Tako ka qenë bashkëpunues në procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij. Ai i është përgjigjur në kohë, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ.

30. Subjekti i rivlerësimit ka sjellë prova dhe shpjegime kur janë nevojitur, ka qenë korrekt dhe i gatshëm për bashkëpunim gjatë të gjitha fazave të hetimit, si dhe gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT I KRYER NGA KOMISIONI

31. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Ky proces kryhet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.

32. Referuar vendimit nr. 2/2017¹⁰, të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016 rezulton se Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (a) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI me deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting*; (b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (c) deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting* të dorëzuar nga subjekti në ILDKPKI; (ç) deklaratat periodike të dorëzuara, ndër vite, dhe provat shkresore të administruara nga ILDKPKI-ja, të cilat gjenden në dosjen e këtij subjekti, dërguar në Komision; (d) provat shkresore/dokumentet e administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50, të ligjit nr. 84/2016; (dh) raportet e kontrollit të figurës të dorëzuar pranë këtij Komisioni nga DSIK-ja; (e) raportin e analizimit të aftësive profesionale të dorëzuar në Komision nga KLP-ja; (ë) denoncimet e publikut; (f) dosjet penale të administruara nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë sipas vendimeve të ndërmjetme të datave 4.5.2022 dhe 10.5.2022; si dhe (g) shpjegimet me shkrim dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit lidhur me rezultatet e hetimit dhe rezultatet e hetimit shtesë, të depozituara në protokollin e Komisionit apo nëpërmjet postës elektronike, si dhe ato gjatë seancave dëgjimore për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

33. Komisioni vlerëson që në këtë vendim të ndërmjetëm, bazuar në nenin 60 të ligjit 84/2016 *“Pezullimi nga detyra dhe detyrimet për të ndjekur programin e trajnimit”*, të trajtojë vetëm ato çështje të cilat lidhen me kriterin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, duke evidentuar mangësitë në aftësitë profesionale që mund të plotësohen me anë të trajnimit në Shkollën e Magjistraturës, bazuar në nenin E dhe në pikën 2, të nenit E, të aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

34. Në lidhje me dy kriteret e tjera, Komisioni do të shprehet në vendimin përfundimtar, pasi subjekti të ketë përfunduar programin e edukimit njëvjeçar pranë Shkollës së Magjistraturës dhe të jetë testuar për aftësitë e tij.

V. VLERËSIMI PROFESIONAL

a. Baza Ligjore

35. Ligji nr. 84/2016 ka përcaktuar se subjektet e rivlerësimit vlerësohen sipas rastit për: i) cilësi të pranueshme apo të papranueshme në punë; ii) gjykim të drejtë apo të dobët; iii) respektim apo mosrespektim të të drejtave të palëve ose viktimave; si dhe iv) të qenit eficient dhe efektiv në masë të pranueshme apo të qenit joefektiv, për të mbërritur përfundimisht në

¹⁰ “41. Për rrjedhojë, gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i pabazuar. Sipas nenit 179/b, pika 5, të Kushtetutës rivlerësimi kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit: ‘Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit’. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryen vetë KPK-ja gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1 të ligjit parashikohet se: ‘Procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Apelit, Komisionerët Publikë, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë’. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse”.

kualifikimin “i aftë”, “me mangësi” apo “i papërshtatshëm”, sipas përcaktimit të nenit 44, pikat “a”, “b” dhe “c”.

36. Sipas përcaktimit të nenit E, pika 2, fjalia e tretë të Aneksit të Kushtetutës dhe të nenit 40 të ligjit nr. 84/2016, në objektin e vlerësimit të aftësisë për prokurorët, përfshihen kriteret e aftësitë për të hetuar dhe për të ngritur akuzën publike, aftësitë organizative, etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale, si dhe cilësitë personale, bazuar në standardet e parashikuara në ligj (të parashikuara dhe në ligjin nr. 96/2016). Qëllimi i vlerësimit të aftësive profesionale sanksionohet drejtpërdrejt nga neni E, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës, sipas të cilës subjektet e rivlerësimit i nënshtrohen një rivlerësimi të aftësisë profesionale, me qëllim identifikimin e atyre të cilët nuk janë të kualifikuar për të kryer funksionin e tyre dhe të atyre të cilët kanë mangësi profesionale që mund të korrigjohen përmes edukimit.

37. Subjekti i rivlerësimit kualifikohet “me mangësi”, kur ka treguar cilësi të papranueshme në punë, gjykim të dobët, nuk ka respektuar normalisht të drejtat e palëve ose viktimave, nuk është efektiv, me pasojë detyrimin nga Komisioni për të kryer program trajnimi pranë Shkollës së Magjistraturës me qëllim për të plotësuar këto mangësi brenda një viti, sipas përcaktimit të nenit E, pikat 1 dhe 3 të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 44, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.

38. Trupi gjykues vlerëson se kualifikimi i subjekteve të rivlerësimit, përkatësisht në të aftë, me mangësi apo të papërshtatshëm, kryhet duke çmuar në tërësi dhe rast pas rasti kriteret e vlerësimit të aftësive profesionale, bazuar në treguesit përkatës, sipas procedurave të parashikuara në ligjin nr. 96/2016, të cilët rezultojnë të jenë të ndërthurur në tregues të natyrës cilësore dhe të vlerësueshëm dhe tregues të natyrës sasiore dhe të matshëm.

39. Sipas përcaktimit të nenit 73, të ligjit nr. 96/2016, kriteri i aftësive profesionale të prokurorit vlerësohet bazuar në aspektet e njohurive ligjore dhe arsytimit ligjor, por pa gjykuar korrektësinë e vendimit dhe themelin e çështjes, si dhe pa zëvendësuar interpretimin ose logjikën e prokurorit që vlerësohet.

39.1 Aspekti i njohurive ligjore vlerësohet duke u bazuar në aftësinë e prokurorit për të hetuar dhe për të marrë urdhra dhe vendime, duke u bazuar në tregues të tillë, si: aftësia e përgjithshme për të ndërmarrë logjikisht hetimin, sipas kërkesave ligjore, për të mbledhur provat e kërkuara me ligj, për të interpretuar ligjin dhe për të analizuar jurisprudencën.

39.2 Më tej, aspekti i arsytimit ligjor të prokurorëve në marrjen e vendimeve dhe veprimeve hetimore, vlerësohet duke u bazuar në tregues të tillë, si: qartësia dhe kuptueshmëria e akteve të prokurorisë, struktura e qëndrueshme dhe e mirorganizuar e akteve të prokurorisë, aftësia për të marrë në pyetje, cilësia e analizës dhe e argumentimit logjik të prokurorit.

40. Sipas përcaktimit të nenit 74, të ligjit nr. 96/2016, kriteri i aftësisë organizative, duke shmangur rrethanat, të cilat nuk varen nga magjistrati dhe që kanë efekt negativ në rezultatet e vlerësimit, vlerësohet në drejtim të aftësisë për të përballuar ngarkesën e punës, për të kryer procedurat gjyqësore, si dhe për të administruar dosjet gjyqësore.

40.1 Aftësia për të përballuar ngarkesën e punës matet duke u bazuar në treguesit për respektimin e afateve ligjore, plotësimin e standardeve minimale kohore, kohën mesatare që i kushtohet çdo çështjeje, rendimentin e përfundimit të çështjeve gjyqësore dhe kohën mesatare për marrjen e vendimit përfundimtar gjyqësor ose të prokurorisë për një çështje.

40.2 Aftësia e prokurorit për të kryer në mënyrë të efektshme procedurat hetimore dhe proceduar të tjera të sistemit të prokurorisë matet duke u bazuar në treguesit e kryerjes së veprimeve të nevojshme hetimore dhe procedurat brenda afatit kohor të përcaktuar, të mbledhjes së provave të nevojshme, duke përfshirë mbikëqyrjen e dërgimit pa vonesë të akteve të nevojshme të njoftimit.

40.3 Aftësia për të administruar dosjet të prokurorisë matet duke u bazuar në treguesit e rregullshmërisë, plotësisë dhe saktësisë së dokumentacionit të dosjes.

41. Sipas përcaktimit të nenit 75, të ligjit nr. 96/2016, kriteri i etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale vlerësohet nëpërmjet etikës në punë, integritetit dhe paanësinë.

41.1 Etika në punë e magjistratit, në lidhje me angazhimin dhe përgjegjshmërinë në funksion, matet duke u bazuar në treguesit e dalë nga burimet e vlerësimit, të tillë si rezultati i ankesave dhe verifikimi i tyre, mendimi i kryetarëve dhe vendimet përfundimtare për masat disiplinore brenda periudhës përkatëse të vlerësimit.

41.2 Integriteti i magjistratit, në lidhje me imunitetin e tij ndaj çdo ndikimi ose presioni të jashtëm, matet duke u bazuar në tregues të tillë si rezultati i ankesave dhe verifikimi i tyre, mendimi i kryetarëve dhe vendimet përfundimtare për masat disiplinore brenda periudhës përkatëse të vlerësimit dhe/ose raportet e Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave.

41.3 Paanësia e magjistratit, në lidhje me kujdesin e tij ndaj konfliktit të interesit dhe respektimin e çështjeve të grupeve në nevojë, duke përfshirë edhe çështjet e barazisë gjinore dhe të pakicave, matet duke u bazuar në tregues të tillë, si: përdorimi i gjuhës diskriminuese, numri tejet i lartë i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e magjistratit, si dhe tregues të tjerë që dalin nga burime të tjera vlerësimi.

42. Sipas përcaktimit të nenit 76, të ligjit nr. 96/2016, kriteri i aftësisë personale dhe angazhimit profesional vlerësohen nëpërmjet aftësive të komunikimit për të bashkëpunuar me kolegët dhe gatishmërisë për t'u angazhuar në veprimtari të tjera.

42.1 Aftësia e komunikimit të magjistratit matet duke u bazuar në treguesit e komunikimit të qartë dhe transparent me palët gjyqësore, publikun, subjektet e tjera, të tretët, në respektim të konfidencialitetit dhe parimeve të mbrojtjes së të dhënave personale. Vlerësimi i aftësive drejtuese si kryetar me të paktën “shumë mirë” ka përparësi në vlerësimin si magjistrat, i cili kryhet pas vlerësimit si kryetar.

42.2 Aftësia për të bashkëpunuar me kolegët matet duke u bazuar në treguesit e komunikimit dhe bashkëveprimit me kolegët apo administratën gjyqësore, si dhe në shkëmbimin e njohurive apo të përvojës profesionale me ta.

42.3 Gatishmëria për t'u angazhuar në veprimtari të tjera matet duke u bazuar në tregues të tillë, si: pjesëmarrja e magjistratit në formimin vazhdues të Shkollës së Magjistraturës, pjesëmarrja në trajnime të tjera profesionale, disponueshmëria e gjyqtarit për të udhëhequr magjistratët e ardhshëm gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e magjistratëve të rinj, pjesëmarrja e magjistratit në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e sistemit të

drejtësisë, veprimtaritë për marrëdhëniet me publikun të gjykatave dhe publikimet ligjore akademike.

42.4 Pjesëmarrja e magjistratit në formimin vazhdues të Shkollës së Magjistraturës matet duke u bazuar në informacionin e dërguar nga Shkolla e Magjistraturës, në vlerësimin “shumë mirë” në rastet e përmbushjes së detyrimit ligjor për të marrë pjesë në formim vazhdues jo më shumë se 40 ditë në vit dhe jo më shumë se 200 ditë gjatë pesë vjetëve. Shkallët e tjera të vlerësimit përcaktohen me rend zbritës nga ky standard.

b. Arsyetimi ligjor

43. Komisioni, pasi analizoi (1) raportin e Këshillit të Lartë të Prokurorisë, (2) të dhënat e administruara nga Prokuroria e Përgjithshme, (3) denoncimet nga publiku, (4) dosjet penale të administruara nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë sipas vendimeve të ndërmjetme të datave 4.5.2022 dhe 10.5.2022, (5) shpjegimet e subjektit pas kalimit të barrës së provës lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht dhe (6) shpjegimet e subjektit mbi rezultatet e hetimit kryesisht shtesë, si dhe dëgjoi atë në seancë dëgjimore, arrin në përfundimin se:

44. Subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë të kundërtën e barrës së provës lidhur me mangësitë profesionale të konstatuara nga Komisioni në: (1) *kërkesat për dërgimin e çështjes në gjykim*, (2) *vendimet e pushimit dhe* (3) *vendimet e mosfillimit*, në të cilat subjekti ka qenë prokuror i çështjes, sipas pikës 3 të nenit E të Aneksit të Kushtetutës dhe shkronjës “b” të nenit 44 të ligjit nr. 84/2016.

45. Për çështjen objekt shqyrtimi, për subjektin e rivlerësimit Gjergji Tako, në funksion të provueshmërisë së fakteve që çojnë në vlerësimin e aftësive profesionale, janë administruar nga Komisioni, dokumentet ligjore në kuptim të nenit 3, pika 2, të ligjit nr. 84/2016, nga të cilat kanë rezultuar mangësi profesionale, të cilat mund të plotësohen me anë të programit të Shkollës së Magjistraturës, si më poshtë vijon:

45.1 Lidhur me kërkesën për gjykimin e çështjes penale nr. ***, të vitit 2014, trupi gjykues vlerëson se kjo kërkesë e përgatitur nga subjekti i rivlerësimit (i) nuk përmban elementët e kërkuar nga neni 331 i Kodit të Procedurës Penale dhe (ii) subjekti i rivlerësimit nuk ka analizuar elementet e figurës së veprës penale për të cilën akuzohen të pandehurit, duke treguar mangësi në aspektin e arsytimit ligjor, bazuar në treguesin e cilësisë së analizës, kriter i parashikuar në pikën 3, të nenit 73, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

45.2 Nga shqyrtimi i vendimit për mosfillimin e procedimit penal lidhur me kallëzimin penal nr. ***, viti 2014, që i referohet vdekjes së shtetasit M. H., dhe akteve të dosjes penale, Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk ka marrë në pyetje bashkëshorten e viktimës me qëllim sqarimin e shkaqeve që kanë çuar në vetëflijim e viktimës duke treguar mangësi në aspektin e njohurive ligjore, bazuar në tregues të tillë si aftësia e përgjithshme për të ndërmarrë logjikisht hetimin sipas kërkesave ligjore, si dhe në kriterin e aftësisë organizative për të kryer procedurat hetimore, kritere të parashikuara në pikën 2, të nenit 73 dhe në pikën 1, të nenit 74, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

45.3 Nga shqyrtimi i vendimit për pushimin e procedimit penal nr. ***, të vitit 2013, vendimit për pushimin e procedimit penal nr. ***, të viti 2017, vendimit për mosfillimin e procedimit penal lidhur me kallëzimin penal nr. ***, datë 16.5.2019, të regjistruar për kryerjen e veprës penale “ekspertim i rremë”, të parashikuar nga neni 309 i Kodit Penal, dhe akteve të dosjeve penale, Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk ka kryer veprimet e nevojshme hetimore për verifikimin e rezultateve të aktekspertimit nëse janë ose jo të rreme duke treguar mangësi në aspektin e njohurive ligjore, bazuar në tregues të tillë si aftësia e përgjithshme për të ndërmarrë logjikisht hetimin, sipas kërkesave ligjore, si dhe në kriterin e aftësisë organizative për të kryer procedurat hetimore, kriteret të parashikuara në pikën 2, të nenit 73 dhe në pikën 1, të nenit 74, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

45.4 Në vendimin për pushimin e procedimit penal nr. ***, të vitit 2014, i regjistruar për veprën penale “shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor”, të parashikuar nga neni 290/3 i Kodit Penal, subjekti i rivlerësimit nuk ka analizuar elementët e figurës së veprës penale, duke treguar mangësi në aspektin e arsytimit ligjor, bazuar në treguesin e cilësisë së analizës, kriteri i parashikuar në pikën 3, të nenit 73, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

45.5 Nga shqyrtimi i akteve të procedimit penal nr. ***, të vitit 2013, të regjistruar për veprat penale “prodhim dhe shitje e narkotikëve” dhe “mbajtje pa leje të armëve luftarake ose municioneve”, të parashikuara nga nenet 283/1 dhe 278/2, 3 të Kodit Penal, Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit: (a) nuk ka përfshirë në dokumentin e njoftimit të akuzës së të pandehurit, akuzën për veprën penale “mbajtje pa leje të municioneve luftarake”, sipas referimit të policisë; (b) akti “Për plotësimin e akuzës” ndaj shtetasit B. Q. për veprën penale “mbajtje pa leje të municioneve luftarake”, të parashikuar nga neni 278/2 të Kodit Penal, është hartuar pa kryer veprime hetimore shtesë; (c) kërkesa për gjykimin e procedimit penal nuk përmban analizën e individualizimit të përgjegjësisë penale për secilin të pandehur, si dhe analizën e elementëve të figurës për veprat penale që akuzohen duke treguar mangësi në aspektin e njohurive ligjore, bazuar në tregues të tillë si aftësia për të hetuar dhe për të marrë urdhra dhe vendime dhe në aspektin e arsytimit ligjor, bazuar në treguesin e cilësisë së analizës, kriteret të parashikuara në pikat 2, 3, të nenit 73, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

45.6 Në kërkesën për gjykimin e procedimit penal nr. ***, të vitit 2013, të regjistruar për veprën penale “vjedhje”, të parashikuar nga neni 134/1, i Kodit Penal, subjekti i rivlerësimit nuk ka pasqyruar vlerësimin mbi faktin penal dhe analizën e elementëve të figurës së veprës penale në ngarkim të pandehurit, duke treguar mangësi në aspektin e arsytimit ligjor, bazuar në treguesin e cilësisë së analizës, kriteri i parashikuar në pikën 3, të nenit 73, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

45.7 Në vendimin për mosfillimin e procedimit penal lidhur me kallëzimin penal nr. ***, të vitit 2019, për kryerjen e veprës penale “ekspertim të rremë”, të parashikuar nga neni 309 i Kodit Penal, përveç mangësive të pasqyruara në pikën “45.3”, të vendimit, arsytimi i subjektit të rivlerësimit se *“çështja është duke u gjykuar nga gjykata civile dhe për çdo pretendim kallëzuesi duhet ti drejtohej kësaj gjykate dhe vetëm pasi gjykata të shprehet me vendim të*

formës së prerë kundër përfundimeve të aktit të ekspertimit, mund të diskutohet nëse gabimet e ekspertit janë ose jo ekspertim i rremë”, nuk është i mbështetur në dispozitat e Kodit të Procedurës Penale si dhe vendimi nuk është i mbështetur në nenin 290/1/ç të Kodit të Procedurës Penale, pasi subjekti i rivlerësimit nuk ka kryer veprime hetimore për të vërtetuar nëse ekspertja ka paraqitur të dhëna haptazi të pavërteta në lidhje me situatën konkrete duke treguar mangësi në aspektin e njohurive ligjore, bazuar në tregues të tillë si aftësia e përgjithshme për të ndërmarrë logjikisht hetimin sipas kërkesave ligjore, për të mbledhur provat e kërkuara me ligj, për të interpretuar ligjin, si dhe në kriterin e aftësisë organizative për të kryer procedurat hetimore, kriteret të parashikuara në pikën 2, të nenit 73 dhe në pikën 1, të nenit 74, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

45.8 Nga shqyrtimi i akteve të procedimit penal nr. ***, të vitit 2015, i regjistruar për veprën penale “falsifikim dokumentesh”, të parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal, Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit: (a) ka marrë vendimin për pushimin e procedimit penal pa administruar provat e nevojshme për të dalë në një konkluzion objektiv dhe ligjor; (b) nuk ka administruar aktet e procedimit penal sipas parashikimeve të nenit 315 të Kodit të Procedurës Penale, (c) ka kërkuar shfuqizimin e vendimit të datës 31.5.2016 për pushimin e procedimit penal pas afro 5 muajve nga ardhja e materialit të ekzekutimit të letërporosisë nga Ministria e Drejtësisë; (ç) kërkesa për ndihmë juridike e përcjellë me shkresën nr. *** prot., datë 25.5.2017, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, ka sjellë si pasojë zvarritje të hetimeve; (d) vendimi i datës 20.6.2017 për pushimin e procedimit penal është marrë pa administruar provat e nevojshme për të dalë në një konkluzion të drejtë ligjor, duke treguar mangësi në aspektin e njohurive ligjore, bazuar në tregues të tillë si aftësia e përgjithshme për të ndërmarrë logjikisht hetimin sipas kërkesave ligjore, për të mbledhur provat e kërkuara me ligj, si dhe në kriterin e aftësisë organizative për të kryer procedurat hetimore, kriteret të parashikuara në pikën 2, të nenit 73 dhe në pikën 1, të nenit 74, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

45.9 Nga shqyrtimi i akteve të procedimit penal nr. ***, të vitit 2017, i regjistruar për veprën penale “ekspertim i rremë”, të parashikuar nga neni 309 i Kodit Penal, përveç mangësive të pasqyruara në pikën “45.3” të vendimit, Komisioni vlerëson se: (a) arsyetimi në vendimin e datës 28.7.2017 për regjistrimin e procedimit penal nr. ***, me arsyetimin se: “*një procedim penal ndaj ekspertëve mund të niste vetëm në fund të shqyrtimit gjyqësor me një vendim të formës së prerë të çështjes*”, nuk është i mbështetur në nenin 309 të Kodit Penal; (b) kërkesa e datës 29.1.2018 për pushimin e çështjes penale nr. *** nuk mbështetet në nenin 309 të Kodit Penal; (c) arsyetimi i subjektit të rivlerësimit në kërkesën e datës 29.1.2018, për pushimin çështjes penale nr. ***, se: “*vendimi i Gjykatës së Lartë përkrah qëndrimin e ekspertëve*”, nuk është i mbështetur në vendimin e Gjykatës së Lartë, duke treguar mangësi në aspektin e arsyetimit ligjor, bazuar në tregues të tillë si aftësia e përgjithshme për të interpretuar ligjin, kriteri i parashikuar në pikën 2, të nenit 73, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

45.10 Nga shqyrtimi i akteve të procedimit penal nr. ***, të vitit 2015, i regjistruar për veprën penale “mjekim i pakujdesshëm”, të parashikuar nga neni 96/1 i Kodit Penal, Komisioni

vlerëson se subjekti i rivlerësimit: (a) në vendimin për regjistrimin e emrit të personit nën hetim, aktin e njoftimit të akuzës të pandehurit dhe në kërkesën për gjykim të datës 25.11.2015, nuk ka arsyetuar lidhur me shkakun determinant të ardhjes së pasojës fatale për jetën të shtetasës M. B.; (b) në aktin e njoftimit të akuzës së të pandehurit dhe në kërkesën për gjykim të datës 25.11.2015 nuk ka arsyetuar lidhur me qëndrimin e kundërt me konkluzionet e aktekspertimit mjeko-ligjor; (c) në kërkesën për gjykim të datës 25.11.2015 nuk ka arsyetuar se cilat janë veprimet apo mosveprimet e të pandehurit që nuk përputhen me protokollet mjekësore, duke treguar mangësi në aspektin e njohurive ligjore, bazuar në tregues si aftësia e përgjithshme për të interpretuar ligjin dhe në aspektin e arsytimit ligjor bazuar në tregues të tillë si cilësia e analizës dhe e argumentimit logjik të prokurorit, kriteret të parashikuara në pikat 2, 3, të nenit 73 të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

45.11 Në kërkesën për gjykimin e procedimit penal nr. ***, të vitit 2018, i regjistruar për veprën penale “pengime për ekzekutimin e vendimeve të gjykatës”, të parashikuar nga neni 320 i Kodit Penal, subjekti i rivlerësimit nuk ka pasqyruar veprimet hetimore për verifikimin e aktit me të cilin ka kaluar në kufi i mituri S. Ç., duke treguar mangësi në aspektin e njohurive ligjore, bazuar në tregues të tillë si aftësia e përgjithshme për të ndërmarrë logjikisht hetimin sipas kërkesave ligjore, për të mbledhur provat e kërkuara me ligj, si dhe në kriterin e aftësisë organizative për të kryer procedurat hetimore, kriteret të parashikuara në pikën 2, të nenit 73 dhe në pikën 1, të nenit 74, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

45.12 Nga shqyrtimi i vendimit për mosfillimin e procedimit penal lidhur me kallëzimin penal nr. ***, të vitit 2014, për kryerjen e veprës penale “ndërtim i paligjshëm”, të parashikuar nga neni 199/a i Kodit Penal dhe akteve të dosjes penale, Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit: (i) nuk ka kryer hetimet e nevojshme për të verifikuar faktin nëse i dyshuari ka ndërtuar në pronë publike; (ii) në vendimin për mosfillimin e procedimit penal nuk ka analizuar ligjin për planifikimin e territorit dhe elementët e figurës së veprës penale, të parashikuar nga neni 199/a i Kodit Penal, duke treguar mangësi në aspektin e njohurive ligjore, bazuar në tregues të tillë si aftësia e përgjithshme për të ndërmarrë logjikisht hetimin, sipas kërkesave ligjore, për të mbledhur provat e kërkuara me ligj, për të interpretuar ligjin, si dhe në kriterin e aftësisë organizative për të kryer procedurat hetimore, kriteret të parashikuara në pikën 2, të nenit 73 dhe në pikën 1, të nenit 74, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

45.13 Në kërkesën për dërgimin e çështjes për gjykim të procedimit penal nr. ***, të vitit 2014, të regjistruar për kryerjen e veprës penale “ndërtim i paligjshëm”, të parashikuar nga neni 199/a i Kodit Penal, subjekti i rivlerësimit, nuk ka analizuar elementët e figurës së veprës penale, duke treguar mangësi në aspektin e arsytimit ligjor, bazuar në treguesin e cilësisë së analizës, kriteret të parashikuara në pikën 3, të nenit 73, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

45.14 Në vendimin për mosfillimin e procedimit penal lidhur me kallëzimin penal nr. ***, të vitit 2014 dhe në kërkesën për dërgimin për gjykim të çështjes penale nr. ***, të vitit 2014, subjekti i rivlerësimit ka mbajtur qëndrime të ndryshme lidhur me anën objektive të kryerjes

së veprës penale “ndërtim i paligjshëm”, të parashikuar nga neni 199/a i Kodit Penal, në rastet kur shtetasit janë konstatuar se po kryenin ndërtim të paligjshëm mbi banesën e tyre ekzistuese.

45.15 Në vendimin për mosfillimin e procedimit penal lidhur me kallëzimin penal nr. ***, të vitit 2014, për kryerjen së veprës penale “dëmtime të tjera me dashje”, të parashikuar nga neni 90 i Kodit Penal, subjekti i rivlerësimit nuk ka pasqyruar analizën ligjore përkatëse, duke treguar mangësi në aspektin e arsytimit ligjor, bazuar në treguesin e cilësisë së analizës, kriteri i parashikuar në pikën 3, të nenit 73, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

45.16 Në vendimin për mosfillimin e procedimit penal lidhur me kallëzimin penal nr. ***, të vitit 2015, për kryerjen e veprës penale “mosbindje ndaj punonjësit që ruan rendin publik”, të parashikuar nga neni 242 i Kodit Penal, subjekti i rivlerësimit nuk ka pasqyruar nenet e Kodit Penal që mbrojnë veprimtarinë e rregullt të organeve të policisë së rendit publik, veprimet ose mosveprimet që parashikon secila dispozitë për t’u konsideruar e konsumuar nga ana objektive vepra penale përkatëse, nuk ka arsyetuar se pse në rastin konkret nuk vërtetohet shkelja e këtyre dispozitave, si dhe nuk ka pasqyruar dispozitat përkatëse procedurale që parashikojnë ankimin drejtpërdrejtë në gjykatë, duke treguar mangësi në aspektin e njohurive ligjore, bazuar në tregues si aftësia e përgjithshme për të interpretuar ligjin dhe në aspektin e arsytimit ligjor bazuar në tregues të tillë si cilësia e analizës dhe e argumentimit logjik të prokurorit, kriteret të parashikuara në pikat 2, 3, të nenit 73 të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

45.17 Nga shqyrtimi i akteve të procedimeve penale: nr. ***, të viti 2013; nr. ***, të vitit 2015; nr. ***, të vitit 2014; nr. ***, të vitit 2016 dhe nr. ***, të viti 2016, të regjistruar për kryerjen e veprës penale “mbajtje lëndë narkotike”, të parashikuar nga neni 283 i Kodit Penal, subjekti i rivlerësimit nuk ka kryer veprimet e nevojshme hetimore në drejtim të përcaktimit të nocionit ligjor-penal “dozë e vogël”, për efekt të zbatimit të nenit 283 të Kodit Penal dhe jurisprudencës së Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë¹¹, dhe në vendimet e pushimit të procedimeve penale nuk ka analizuar elementët e figurës së veprës penale për të cilën akuzohen të pandehurit/dyshuarit, duke treguar mangësi në aspektin e njohurive ligjore, bazuar në tregues si aftësia e përgjithshme për të interpretuar ligjin dhe për të analizuar jurisprudencën si dhe në aspektin e arsytimit ligjor bazuar në tregues të tillë si cilësia e analizës, kriteret të parashikuara në pikat 2, 3, të nenit 73 të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Përveç këtyre konstatimeve, subjekti i rivlerësimit në tri raste¹² nuk ka kërkuar kryerjen e aktekspertimit kimik të lëndës së sekuestruar dhe në një rast¹³ nuk ka administruar aktekspertimin toksikologjik, duke treguar mangësi në aspektin e njohurive ligjore, bazuar në tregues të tillë si aftësia e përgjithshme për të ndërmarrë logjikisht hetimin, sipas kërkesave ligjore, për të mbledhur provat e kërkuara me ligj, si dhe në kriterin e aftësisë organizative për të kryer procedurat hetimore, kriteret të parashikuara në pikën 2, të nenit 73 dhe në pikën 1, të nenit 74, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

¹¹Vendimi unifikues nr. 1, datë 27.3.2008.

¹²Procedimet penale: nr. ***, nr. ***, dhe nr. ***.

¹³Procedimi penal nr. ***.

45.18 Në vendimin për pushimin e procedimit penal nr. ***, të vitit 2014, i regjistruar për kryerjen e veprës penale “ndotja e ajrit”, të parashikuar nga neni 201 i Kodit Penal, subjekti i rivlerësimit nuk ka analizuar legjislacionin për mbrojtjen e mjedisit lidhur me nivelin e parametrave të shkarkimit në ajër të elementëve kimikë, me qëllim arritjen e përfundimit nëse veprimet e të dyshuarit janë kundërvajtje administrative apo penale, në kundërshtim me nenin 201 të Kodit Penal, duke shfaqur mangësi në aspektin e njohurive ligjore, bazuar në tregues të tillë si aftësia e përgjithshme për të interpretuar ligjin dhe në aspektin e arsytimit ligjor në marrjen e vendimit, duke u bazuar në tregues të tillë si cilësia e analizës dhe e argumentimit logjik, kritere të parashikuara në pikat 2, 3, të nenit 73, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

45.19 Nga shqyrtimi i akteve të procedimit penal nr. ***, të vitit 2015, i regjistruar për kryerjen e veprës penale “shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor”, të parashikuar nga neni 290 i Kodit Penal, Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit: (a) nuk ka kryer veprimet e nevojshme hetimore për sqarimin e anës objektive të veprës penale; (b) nuk ka kryer veprimet e nevojshme hetimore me qëllim përcaktimin e anës subjektive të kryerjes së veprës penale të dyshuar, duke treguar mangësi në aspektin e njohurive ligjore, bazuar në tregues të tillë si aftësia e përgjithshme për të ndërmarrë logjikisht hetimin, sipas kërkesave ligjore, për të mbledhur provat e kërkuara me ligj, si dhe në kriterin e aftësisë organizative për të kryer procedurat hetimore, kritere të parashikuara në pikën 2, të nenit 73 dhe në pikën 1, të nenit 74, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

45.20 Në kërkesën për dërgimin për gjykim të procedimit penal nr. ***, të vitit 2013, i regjistruar për kryerjen e veprës penale “dhunë në familje”, të parashikuar nga neni 130/a/1 i Kodit Penal, subjekti i rivlerësimit, nuk ka analizuar elementët e figurës së veprës penale, duke treguar mangësi në aspektin e arsytimit ligjor, bazuar në treguesin e cilësisë së analizës, kriter i parashikuar në pikën 3, të nenit 73, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

45.21 Në kërkesën për dërgimin për gjykim të procedimit penal nr. ***, të vitit 2015, i regjistruar për kryerjen e veprës penale “mashttrim”, të parashikuar nga neni 143 i Kodit Penal, subjekti i rivlerësimit nuk ka analizuar elementët e figurës së veprës penale për të cilën akuzohet i pandehuri, duke treguar mangësi në aspektin e arsytimit ligjor, bazuar në treguesin e cilësisë së analizës, kriter i parashikuar në pikën 3, të nenit 73, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

45.22 Në kërkesën për dërgimin për gjykim të procedimit penal nr. ***, të vitit 2015, i regjistruar për kryerjen e veprës penale “fshehje të ardhurash”, të parashikuar nga neni 180 i Kodit Penal, subjekti i rivlerësimit nuk ka bërë analizën e elementëve të figurës së veprës penale për të cilën akuzohet i pandehuri, me qëllim arritjen e një konkluzioni të drejtë lidhur me cilësimin juridik të veprës penale, duke shfaqur mangësi në aspektin e njohurive ligjore, bazuar në tregues të tillë si aftësia e përgjithshme për të interpretuar ligjin dhe në aspektin e arsytimit ligjor në marrjen e vendimit, duke u bazuar në tregues të tillë si cilësia e analizës dhe e argumentimit logjik, kritere të parashikuara në pikat 2, 3, të nenit 73, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

45.23 Në vendimin për pushimin e procedimit penal nr. ***, të vitit 2016, i regjistruar për kryerjen e veprës penale “ushtrim i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike”, të parashikuar nga neni 245/1 i Kodit Penal, subjekti i rivlerësimit nuk ka analizuar elementët e figurës së veprës penale të dyshuar, me qëllim arritjen e një konkluzioni të drejtë nëse të dyshuarit kanë konsumuar veprën penale përkatëse, duke shfaqur mangësi në aspektin e njohurive ligjore, bazuar në tregues të tillë si aftësia e përgjithshme për të interpretuar ligjin dhe në aspektin e arsytimit ligjor në marrjen e vendimit, duke u bazuar në tregues të tillë si cilësia e analizës dhe e argumentimit logjik, kritere të parashikuara në pikat 2, 3, të nenit 73, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

45.24 Në vendimi për pushimin e procedimit penal nr. ***, të vitit 2016, i regjistruar për kryerjen e veprës penale “shkelje e barazisë në tendera”, të parashikuar nga neni 258 i Kodit Penal, subjekti i rivlerësimit nuk ka analizuar elementët e figurës së veprës penale të dyshuar, me qëllim arritjen e një konkluzioni të drejtë ligjor nëse të dyshuarit kanë konsumuar veprën penale përkatëse, duke shfaqur mangësi në aspektin e njohurive ligjore, bazuar në tregues të tillë si aftësia e përgjithshme për të interpretuar ligjin dhe në aspektin e arsytimit ligjor në marrjen e vendimit, duke u bazuar në tregues të tillë si cilësia e analizës dhe e argumentimit logjik, kritere të parashikuara në pikat 2, 3, të nenit 73, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

46. Në përfundim të analizimit të dokumenteve ligjore të paraqitura më lart, trupi gjykues i Komisionit, pasi shqyrtoi kriteret e vlerësimit të aftësive profesionale, sipas përcaktimeve të nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, vlerëson se subjekti i rivlerësimit: (1) ka mangësi në drejtim të njohurive ligjore bazuar në aftësinë për të hetuar, duke mos ndërmarrë logjikisht hetimin sipas kërkesave të ligjore, duke mos mbledhur provat e kërkuara me ligj dhe duke mos interpretuar ligjin; (2) ka mangësi në drejtim të arsytimit ligjor bazuar në mosqartësimin dhe moskuptueshmërinë e akteve të prokurorisë, dhe mos analizimin dhe arsytimin logjik të prokurorit, sipas parashikimeve në pikës 2 dhe 3 të nenit 73 të ligjit 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

46.1 Komisioni konkludon se subjekti ka pasur detyrimin ligjor për të ndërmarrë logjikisht hetimin sipas kërkesave ligjore, të thellohej në arsytimin e vendimeve, të pasqyronte analizën e elementëve të figurës së veprës penale, të vepronte në përputhje me jurisprudencën e Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, si dhe të analizonte legjislacionin përkatës në rastet kur dispozita e Kodit Penal ishte *blankete* (e bardhë).

46.2 Për këto arsye dhe për sa janë analizuar më sipër, sipas përcaktimeve të nenit 44, germa “b”, të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit konsiderohet “Me mangësi”, të cilat mund të plotësohen duke ndjekur programin e trajnimit pranë Shkollës së Magjistraturës, brenda 1 viti.

KONKLUZION

46.3 Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, mbështetur në burimet e vlerësimit, rezultatet e hetimit, prapësimet e subjektit të rivlerësimit me shkrim dhe në seancat dëgjimore publike, mori në shqyrtim të gjitha pretendimet dhe provat e parashtruara nga subjekti i rivlerësimit, si dhe

bisedoi në prani të vëzhguesit ndërkombëtar marrjen e vendimit, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka shfaqur mangësi në aftësitë e tij profesionale, mangësi të cilat mund të plotësohen nëpërmjet programit të trajnimit pranë Shkollës së Magjistraturës.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, në bazë të nenit 58, pika 1, germa “b”, nenit 44, germa “b”, si dhe të nenit 60, pika 1, të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Pezullimin nga detyra të z. Gjergji Tako për një periudhë njëvjeçare dhe detyrimin për të ndjekur programin e trajnimit, sipas kurrikulave të miratuara nga Shkolla e Magjistraturës.
2. Në përfundim të këtij trajnimi, pas administrimit të rezultateve të arritura nga subjekti, Komisioni do të përfundojë procesin e rivlerësimit bazuar mbi të tria kriteret e vlerësimit.
3. Ky vendim i njoftohet subjektit të rivlerësimit, vëzhguesve ndërkombëtarë, si dhe Shkollës së Magjistraturës brenda 30 ditëve pas kësaj seance dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
4. Ky vendim është i paankimueshëm, bazuar në pikën 2, të nenit F, të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Roland ILIA
Kryesues

Etleda ÇIFTJA
Relatore

Pamela QIRKO
Anëtare

Sekretare gjyqësore
Resilda Bilaj